20 vjeç "terrorizoi" Tiranën me vjedhje me dhunë, sot 30-vjeçari kapet me armë në brez (PAMJET)

Silvester Sylaj 30 vjeç u arrestua nga policia në Tiranë, pasi lëvizte i armatosur me pistoletë me fishekë në fole. Më vitin 2015 kur ishte vetëm 20 vjeç, ai ishte arrestuar dhe dënuar për kryerjen e të paktën 8 vjedhjeve nën kërcënimin e armës, po në kryeqytet.

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Redaksia
3 Shtator, 10:17 | **Përditësimi: 3 Shtator, 16:07**

Share

TIRANË – Forcat Shqiponja ndaluan në rrugën "Ibrahim Rugova" në Tiranë një të dyshuar, duke lëvizur në këmbë me armën që e mbante në brez. Kur i vunë prangat dhe i morën armën, pistoleta ishte me fishekë në fole. Nuk dihet ende se çfarë veprimi kriminal do të bënte i riu, i përgatitur për të bërë çitje.

Nga verifikimet, i ndaluari, rezultoi të jetë Silvester Sylaj, me banim në Tiranë, dhe i lindur në Vlorë, i dënuar më parë për armëmbajtje pa leje dhe vjedhje me dhunë në kryeqytet. Ndaj dhe operacioni u kodua "Again" (Përsëri).

Në 2015-ën, 10 vite më parë, kur ishte vetëm 20 vjeç kishte rënë sërish në prangat e policisë. Të paktën 8 vjedhje të dhunshme nën kërcënimin e armës, po në kryeqytet, mbanin autoritetsi e tij. Në atë kohë, në banesë policia i gjeti armë, një automatik, maskë dhe armë të ftohta, mjete me të cilat kryente grabitjet.

LEXO EDHE:
Kombëtarja në alarm për të ardhmen, Moldavia U-19 mposhti 0-1 Shqipërinë në Tiranë

Sipas policisë 10 vite më parë, i riu kishte vjedhur nën kërcënimin e armës në 2 vende pune, në një furrë buke, 40 mijë lekë dhe në një pikë lojërash fati, mbi 32 mijë lekë të rinj. Në ditë të ndryshme, por me afërsi kohore të 10 viteve më parë, ka vjedhur në 3 banesa, shuma parash dhe bizhu. Në dy episode të tjera ka vjedhur pasqyrat dhe kasetofonë nga automjetet e parkuara. Në një vjedhje, të 1 gushtit 2015, Silverster Sylaj, kërcënoi me sëpatë një person në rrugë duke i vjedhur 10 mijë lekë dhe celularin.

Ndërkohë në aksionin e kësaj të mërkure, forcat e posaqme "Shqiponja" arrestuan edhe mikun e tij, 35-vjeçarin Erjon Tafilaku, i cili e shoqëronte Sylajn. Ai akuzohet për moskallëzim krimi.

> ***Njoftimi i policisë:***
>
> *Finalizohet operacioni policor i koduar "Again". Lëvizte i armatosur me pistoletë me fishek në fole, kapet në flagrancë dhe vihet në pranga 30-vjeçari, i dënuar më parë për armëmbajtje pa leje dhe për vjedhje me dhunë. Vihet në pranga dhe shoku i tij, për moskallëzim krimi. Sekuestrohet pistoleta me municion luftarak.*
>
> *Shërbimet e Forcës së Posaçme "Shqiponja", në vijim të punës për evidentimin dhe goditjen e rastave të armëmbajtjes pa leje, bazuar dhe në informacionet e siguruara për një shtetas që lëvizte i armatosur, kanë organizuar dhe finalizuar operacionin policor të koduar "Again".*
>
> *Gjatë operacionit, shërbimet e Policisë kanë kapur në flagrancë në rrugën "Ibrahim Rugova", shtetasin S. S., duke lëvizur me këmbë, me 1 armë zjarri pistoletë me fishek në fole, që e mbante në brez.*
>
> *Në vijim të veprimeve procedurale, specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Nr. 2 arrestuan shtetasit: S. S., 30 vjeç, banues në Tiranë, me precendent të theksuar penal dhe E. T., 35 vjeç, i cili shoqëronte 30-vjeçarin.*

K.M/r.k./Shqiptarja.com

TAG: Tirane | Silveste Sylo | Erjon Tafilaku | armembajtje pa leje

Komento

Komente

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
4 Shtator, 18:18
A jeni dakord me propozimin e Ramës për heqjen e depozitave të ujit nga pallatet?

Po | Jo | Nuk kam mendim

Lajme të tjera

Depozitat, 'çatitë e dyta' mbi pallatet e njetra në Tiranë, banorët për Report Tv: Po i hoqët morëm fund, uji në çezmë 6-9 orë në ditë (VEZHGIMI)

Eliza Gjediku

4 Shtator, 16:13

Bie nga ballkoni, humb jetën 40-vjeçarja në Tiranë

4 Shtator, 14:30

Tiranë/ Nuk deklaroi 1 mln euro fitime, bllokohet klinika private 'International Medicare'! Pranga administratorit, në kërkim 2 aksionerët! Përdorën ilaçe të skaduara

Sokol Dema

4 Shtator, 11:58

Viti i ri shkollor, Veliaj mesazh nxënësve nga qelia: Tim bir s'e shoqëroj dot në klasë të parë, m'u thye zemra! Bëhuni gjahtarë idesh dhe jo njerëzish

4 Shtator, 11:30

Nga data 8 deri më 11 shtator, Shqipëria mirëpret Javën Kulturore Malazeze! Nga shfaqjet muzikore te ekspozitat, falas për publikun

4 Shtator, 11:29

E ngarkuara me punë e SHBA-së viziton Spiropalin në Kryesinë e Kuvendit! Takim edhe me Gonzaton dhe zyrtarën e PE për Ballkanin (VIDEO)

4 Shtator, 10:57

Lëvizte i armatosur me pistoletë, arrestohet 22-vjeçari në Tiranë! Momenti kur ndalohet nga policia (EMRI+VIDEO)

4 Shtator, 10:28

Celularët në shkollë vetëm me "lejen" e prindit! Udhëzimi: Gjatë mësimit "kyçen" në kuti

Joana Preja

3 Shtator, 17:57

Lirimi i hapësirave publike, Rama: Ritet çdo ditë sipërfaqja e çliruar në kryeqytet, po punojmë për projekte të reja

3 Shtator, 17:32

Tiranë/ Nxiste të miturit të kryenin vjedhje në zona të ndryshme, pranga 39-vjeçarit (EMRI)

3 Shtator, 15:31

Ngacmoi seksualisht 19-vjeçaren, arrestohet 35-vjeçari në Tiranë

3 Shtator, 14:22

Teatri i Kukullave, së shpejti me hapësirë muzeale! Ministri Gonxhja: Do pasurohet me ekspozitoré, kënd suvenireshë dhe instalacione artistike

3 Shtator, 13:36

© 2011 - 2025 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i pasaktësuar i kësaj faqeje